

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit N.N.P”T.” në P., të cilin e përfaqësoj av.N.Th. nga P., ndaj të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Shëndetësisë-Departamenti i Prokurimit në Prishtinë, për shkak të borxhit, në vlerë prej 12.895,00 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës; 22.09.2014, në prani të të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të të paditurit, ndërsa me datën; 07.10.2014 merr këtë:

### A K T G J Y K I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpadija e paditësit NNP “T.” me seli në P. dhe

I.DETYROHET e paditura Qeveria e Kosovës-Ministria e Shëndetësisë-Departamenti i Prokurimit me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj shumën në vlerë të përgjithshme prej 12.895,00 euro (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë euro), në emër të punëve shtesë në objektin e ndërtuar sipas kontratës me nr.71000/09/131/521 e datës 29.06.2009, me kamatë ligjore prej 3.5%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 01.07.2010 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat parativ prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.DETYROHET i padituri, që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 688,80 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

### A r s y e t i m

Paditësi N.N.P ” T. “ me seli në P.,përmes përfaqësuesit të saj av. N. Th. nga P., ka parashtruar padi pranë kësaj Gjykate kundër Qeverisë së Kosovës-Ministria e Shëndetësisë-Departamenti i Prokurimit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që në emër të punëve të kryera shtesë në objektin QKMF me seli në Skenderaj t’ia paguaj shumën prej 12.895,00 euro, me kamatë ligjore 3.5% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 01.07.2010 e deri në pagesën definitive, njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Paditësi në padi dhe parashtruesat e saja të dorëzuara në këtë gjykatë, e poashtu edhe në seancat e mbajtura ka potencuar se pas përfundimit të punëve kryesore sipas kontratës me nr.71000/09/131/521 e datës 29.06.2009, në objektin QKMF në Skenderaj, ka kryer edhe punë tjera shtesë më pëlqimin e punëdhënësit të cilat edhe ashtu janë paraparë sipas kontratës për punë kryesore në shumë prej 10% të vlerës të punëve kryesore të kryera, ka cekur se një pëlqim i tillë është dhënë nga Departamenti i Prokurimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë i cili është nënshkruar nga zyrtari i prokurimit Ismet Hyseni, e që njëherit është edhe nënshkruar e kontratës bazë-kryesore. Punët shtesë sipas paditësit, janë lejuar edhe nga organi mbikqyrës për cka është hartuar raporti mbi verifikimin e pozicioneve. Në seancën kryesore paditësi e ka precizuar kërkesëpadinë në shumën prej 12,895,00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura e ka kundërshtuar padinë dhe kërkespadinë duke cekur se kërkespadisë i mungon baza ligjore ngase sipas dispozitës së nenit 20 paragrafi 1 të kontratës bazë nuk përfshihen edhe punët shtesë por ajo ka të bëjë me punët e paparashikuara të specifikuara në nenin 8 pika 4 të kontratës gjegjëse. Po ashtu ka shtuar se oferta për punët shtesë nuk paraqet bazë juridike për marrëdhënjet detyimore në mes të palëve e as detyrim për pagesën e punëve të kryera jashtë kontratës bazë. Kërkesa e punëve shtesë nga organi mbikqyrës, sipas të paditurës nuk paraqet kurrëfarë detyrimi për punëdhënësin sepse organi mbikqyrës nuk është subjekt i autorizuar për lidhjen e kontratës shtesë. Sipas të paditurës edhe ditari i punëve të kryera ndërtimore dhe libri ndërtimor nuk paraqet kurrëfarë baze juridike që punëdhënsi të paguaj vlerën e punëve shtesë. Ka propozuar që të hudhet padia dhe kërkesëpadia si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka administruar provat e propozuara nga palët në procedurë dhe atë: certifikata e biznesit e paditësit NNP "T." me nr. *numër i biznesit...* e dt. 04.06.2009, kërkesa për punë shtesë të drejtuar në APP-n nr.ref. 1334/09 e dt. 21.12.2009, kërkesa e autorizimit dhe deklarata për APP-n e dt. 16.12.2009, me nr. 1334/09, punimet shtesë në renovimin QKMF-Skenderaj me nr. 055682 e dt. 07.12.2009, ofertë për punë shtesë, procesverbali i komisionit për pranim teknik të renovimit të objektit të QKMF-Skenderaj, e dt. 18.12.2009, me nr. 351-506, kontrata për punë e dt. 29.06.2009, fatura e dt. 17.12.2009, e dt. 10.03.2009, (në bazë të Ligjit mbi ndërtim dhe 10% është i përfshirë në këtë shumë), kërkesa e paditësit drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë zyrës së prokurimit e dt. 21.05.2014, përgjigjia në kërkesë nga B. M. e dt. 12.06.2014, E-maili nga përfaqësuesja e të paditurës për drejtoreshën e departamentit ligjor F. Sh. - zyrtare ligjore dhe përgjigjia nga B. M. drejtuar F. A. e dt. 09.07.2014.

Dhe pas vlerësimit të secilës vec e vec edhe lidhshmërinë e tyre ka gjetë këtë gjendje të fakteve, nuk është kontestuese se në mes të palëve në procedurë është lidhur kontratë me nr. 71000/09/131/521 e dt. 29.06.2009 për renovimin e objektit të QKMF në Skenderaj. Nuk është kontestuese se pas përfundimit të punëve ndërtimore në objektin e cekur janë bërë edhe punët shtesë të nevojshme të cilat më parë nuk kanë qenë të përfshira në kontratën bazë. Nuk është kontestuese fakti se mbikqyrësi i punëve i caktuar nga e paditura ka kërkuar dhe ka dhënë pëlqimin për kryerjen e punëve shtesë, nuk është kontestuese as vlera e punëve shtesë në shumë prej 12.895,00 euro. Nuk është kontestuese as fakti se nga Departamenti i Prokurimit, të cilit i është drejtuar oferta ka aprovuar dhe nënshkruar pëlqimin për punë shtesë nga zyrtari i prokurimit Ismet Hyseni i cili edhe është nënshkruar i kontratës bazë, po ashtu nuk është kontestuese se Departamenti i Prokurimit i ka arsyetuar arsyeshmërinë e punëve shtesë në këtë objekt dhe për këtë e ka dhënë pëlqimin. Nuk është kontestuese se me rastin e pranimin teknik antarët e komisionit të kenë konstatuar se punëve janë kryer sipas kontratës bazë dhe kushteve parapa teknike dhe profesionale dhe se punimet shtesë kanë përfunduar në të gjitha pozicionet konform rregullave teknike.

Ajo që është kontestuese në mes palëve në procedurë se e paditura e konteston bazën ligjore duke cekur se në mes palëve nuk ka ekzistuar një kontratë shtesë-aneks për kryerjen e punëve shtesë në objektin QKMF në Skenderaj, dhe se për këtë arsye nuk ekziston baza ligjore për një kërkesë të tillë.

Gjykata duke i vlerësuar provat e administruara dhe pretendimet e palëve në procedurë gjenë se paditësi ka kryer dhe i ka përfunduar punët shtesë që kapin shumën prej 12.895,00 euro.

Këto punë shtesë paditësi i ka kryer pasi që më parë ka marrë pëlqimin nga mbikqyrësi i punimeve në objektin për të cilën edhe është lidhë kontrata bazë dhe pasi që paditësi ka dërguar ofertën për lejimin e kryerjeve të punëve shtesë Departamentit i prokurimit tek i padituri dhe i njëjti Departament ka dhënë pëlqimin për kryerjen e punëve shtesë duke u bazuar në nenin 14 të kontratës bazë. Se me të vërtet janë kryer punët shtesë Gjykata ka vërtetuar nga raporti i komisionit për pranimin teknik ,nga evidenca e situacioneve të punëve shtesë,si dhe nga përmbatja e E-mail të shkëmbyer në mes palëve në procedurë.Por tek e fundit në mes palëve fakti se punë shtes janë kryer dhe se vlera e tyre punëve është 12.895,00 euro.

Duke pas parasysh gjitha këto fakte duhet konstatuar se në mes të palëve ka ekzistuar vullneti për një zgjerim-aneks kontratë për punët shtesë në objektin për të cilën është lidhë kontrata bazë,një vullnet i tillë është shprehur edhe nga e paditura në mënyrë të heshtur por edhe me deklaram,aprovim të personave zyrtare e të paditurës, në nenin 28 LMD-së parasheh deklarinimin e vullnetit për ta lidhë një kontratë me shenja të zakonshme ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet ekzistimi i vullnetit.

Në rastin konkret pranimi i punëve të kryera shtesë,dhënia e pëlqimit dhe mos kundërshtimi për punët e kryera shtesë nga të autorizuarit e të paditues lenë të kuptohet në mënyr të sigurt se e paditura lirisht dhe me seriozitet ka shpreh vullnetin për zgjerimin apo kontratën shtesë për punët shtesë në objektin për të cilën edhe është lidhë kontrata bazë.

Edhe neni 42 paragrafi 3 të LMD-së parasheh se i ofertuari kur ndodhet në lidhje të vazhdueshme afariste me ofertuesin lidhur me punët apo mallin e caktuar konsiderohet se ka pranuar ofertën nëse nuk e ka refuzuar menjëherë ose brenda afatit që i është lënë,andaj edhe sipas standarteve të së drejtës detyrimore në rastin konkret konsiderohet se në mes të paditësit dhe të paditurit është plotësuar kontrata bazë për punët shtesë në vlerë prej 12.895.00euro e cila shumë është në përputhje me nenin 14 të kontratës bazë.

Edhe në nenin 633 të LMD-së parashihet që për çdo largim nga projekti i ndërtimeve,repsektivisht nga punimet e kontraktuar,zbatuesi duhet ta ketë pëlqimin shkresor të porositësit,andaj,edhe një pëlqim i tillë shkresor ekziston në emërtimin Kërkesë Autorizimi dhe Deklarta për APP me nr.e prokurimit 7100/09/13521 e dt.16.12.2009 e cila kërkesë është e nënshkruar dhe aprovuar nga autoriteti i të paditurit pikërishtë i nënshkruar nga zyrtari Ismet Hyseni .Kështu përmbushet edhe detyrimi i paraparë në nenin 633 të LMD-së.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroj të paditurën që t'ia paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 3,5%,duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Lartësia e kamatës në rastin konkret, i referohet shkallës së kamatës, të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë,për mjetet e deponuara pa destinim dhe për periudhën kohore të deponimit, me shumë se për një vit.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së,në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së përgjithshme të precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet e kërkuara dhe të argumentuara nga paditësi dhe atë: për taksën e padisë shumën prej 74,00 €,për përfaqësime në 4 seanca (4X135,20 euro) shumën prej 540,80 € dhe taksën për aktgjykim shumën prej 74,00 €.

Andaj Gjykata bazuar në dispozitat e nenit 633 të LMD-së,si dhe në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së,ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-  
III.C.nr.543/2013, me dt;07.09.2014

Gjyqtarja  
Franciska Zhitia-Ymeri

UDHËZIME JURIDIKE:Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj gjykate.